

Për:	Operatori Ekonomik: WOOD CORPORATION L.L.C., Rr. Ukë Bytyqi, 23000, Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	06.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **05.06.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **WOOD CORPORATION L.L.C.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **WOOD CORPORATION L.L.C.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **30.05.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **WOOD CORPORATION L.L.C.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **30.05.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **05.06.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar asnjë kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit;

Ju bashkëngjisim edhe njëherë Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve te ofruara me katalogë broshura

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2: Katalogu me fotografi dhe specifikacion detal për të gjitha produktet siç kërkohet në specifikimet teknike

Sqarimet janë si në vijim:

Oferta juaj është e papërgjegjshme për faktin se nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike të detyrueshme të përshkrimit të çmimeve.

I njëjti për artikullin nr. 8 ku është kërkuar: “Karrige lëvizëse me mbështetëse të krahëve nga druri”

Ju si Operator Ekonomik jeni te papërgjegjshme për faktin se nuk ka ofertuar karrigen lëvizëse me mbështetëse të krahëve nga druri, konform kërkesës së dosjes se tenderit, sepse keni prezantuar karrigen lëvizëse me krah te plastikes, e jo materiali i drurit.

Sikurse është sqaruar në pikat e mësipërme, produktet e ofertuar nuk përmbush kërkesat e specifikuara nga Autoriteti Kontraktues.

Bazuar në Nenin 59 të LPP-së, paragrafi 4, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.... sqarojmë se nuk janë plotësuar kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Në një rast të tillë, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve, i RRUOPP – së e sqaron si në vijim: “Është dorëzuara katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara”, atëherë “Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”

Andaj oferta juaj e dorëzuar nuk e plotëson Kërkesën me Nr. 2 të Kapaciteti teknik dhe professional, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ, kemi shembullin se si duhet vepruar:

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm -	69
--	---	----

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit